REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPSTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 267
Datë/Datum 03 09 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 03.09.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 02.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 1544, të datës 02.09.2026, të paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (f), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 30 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), dhe nenin 27, shkronja (c, ç, nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M
Për aprovimin e Propozimit Nr. 1544, të datës 02.09.2026 për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1544, të datës 02.09.2026, për ridestinimin e mjeteve financiare në shumë prej: 450,000.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, programi Buxhetimi me Nr. 17502, kodi i projektit Nr. 54403 'Bashkëfinancimi i Projekteve' dhe bartjen e tyre për shpenzim në Drejtorinë e Infrastrukturës, programi Infrastruktura Rrugore me Nr. 18002, për realizimin e projektit kapital për 'Asfaltimin e rrugës 'Ejup Gashi' me infrastrukturë përcjellëse në gjatësi prej 1300 metra' - në kodin e projektit Nr. 20945'.

2. Mjetet financiare të ridestinuara në programet buxhetore dhe kodet e projekteve përkatëse, do të shfrytëzohen për realizimin e projektit kapital të evidentuar në paragrafin një (1) të këtij vendimi, me Nr. 20945.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe Drejtorisë së Infrastrukturës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - KUVENDI I KOMUNËS - REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA KOSOVO POLJE
FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faqe/Br.str. 268
Data/Datum 03 09 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 03.09.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 02.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 1490, të datës 24.09.2026, të paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim dhe ndërrimin e emrit të projekt për vitin 2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (f), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 30 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), dhe nenin 27, shkronja (c, ç, nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 1490, të 24.08.2026 për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026 dhe ndërrimin e emërtimit të ri të projektit kapital

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1490, të datës 24.08.2026, për ridestinimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej: 170,000.00€, nga projekti kapital në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, programi buxhetor Zhvillimi Ekonomik Lokal Nr. 48002, për ndërrimin e emërtimit të projekt kapital 'Sistemi solar në institucionet e Administratës, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Arsimit', kodi i projektit Nr. 56109 dhe bartjen e tyre për shpenzim në projektin e Drejtorinë e Shërbimeve Publike, programi buxhetor Infrastruktura Publike Nr. 18162, për realizimin e projektit kapital me emërtim të ri 'Zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për qasje të re në Parkun Rekreativ të Pishave' nga fondet burimore - burmet e financimit si vijon:

1.1 Shuma e mjeteve financiare prej: 100,000.00€ nga Granti qeveritar për realizimin e projektit kapital 'Zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për qasje të re në Parkun Rekreativ të Pishave' dhe

1.2 Shuma e mjeteve financiare prej: 70,000.00€ nga të Hyrat vetanake të komunës për realizimin e projektit kapital 'Zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për qasje të re në Parkun Rekreativ të Pishave'.

2. Mjetet financiare të ridestinuara për realizimin e projektit kapital me emërtim të ri 'Zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për qasje të re në Parkun Rekreativ të Pishave', do të shfrytëzohen për realizimin e projektit kapital të evidentuar në paragrafin një (1), nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij vendimi.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Buxhetit e Financave, Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 269
Data/Datum. 03 09 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 03.09.2026

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 02.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1427, të datës 11.08.2026, për ridestinimin, transferimin dhe rishpërndarjen e mjeteve financiare nga projekti kapital 'Blerja e pajisjeve për shkollat fillore në Fushë-Kosovës', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (f), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 30 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), dhe nenin 27, shkronja (c, ç, nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 1427, të datës 11.08.2026 për ridestinimin, transferimin dhe rishpërndarjen e mjeteve financiare në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2026

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1427, të datës 11.08.2026, për ridestinimin, transferimin dhe rishpërndarjen e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej: 150,000.00€, programi Administrata e Arsimit Nr, 92010, nga projekti kapital 'Blerja e pajisjeve për shkollat fillore në Komunën e Fushë-Kosovës', kodi i projektit Nr. 20854, nga kategoria Investime Kapitale Nr. 30, në kategorinë Mallëra dhe Shërbime Nr. 13, si vijon:

1.1 Shuma e mjeteve financiare prej: 100,000.00€ nga fondi burimor 10, transferohen për shpenzim prej kodit funksional Nr. 0912, nga kategoria ekonomike Nr. 30, në kodin funksional Nr. 0912, në kategorinë ekonomike Nr. 13 dhe

1.2 Shuma e mjeteve financiare prej: 50,000.00€ nga fondi burimor 21, transferohen për shpenzim prej kodit funksional Nr. 0912, nga kategoria ekonomike Nr. 30, në kodin funksional Nr. 0912, në kategorinë ekonomike Nr. 13.

2. Shumat e mjeteve financiare të evidentuara në paragrafin 1 dhe nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2, për mallëra dhe shërbime shpenzohen në programet buxhetore: Arsimi Fillor Nr. 93030 - Shkolla Fillore 'Mihal Grameno', Fushë-Kosovë, nën-programi Nr. 93031, prej fondit burimor Nr. 10 dhe Arsimi Fillor Nr. 93030 - Shkolla Fillore 'Mihal Grameno', Fushë-Kosovë, nën-programi Nr. 93031, prej fondit burimor Nr. 21.

3. Mjetet financiare të transferuara nga paragrafi një dhe dy, të këtij vendimi do të shfrytëzohen për 'Blerjen e inventarit shkollor për objektin e ri shkollor të ndërtuar në rrugën 'Fazli Grajçevci', me pajisje bazë, në veçanti banka dhe karrige për shkollën e re.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe Drejtorisë së Arsimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për Arsim, Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS FUSHË KOSOVË * SKUPŠTINA OPŠTINA KOSOVO POLJE
FUSHË KOSOVË
KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fax/Br.str. 274
Datë/Datum 09. 09. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 08.09.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 02.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1489, të datës 24.08.2026, të paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, përmes Kryetarit të Komunës, lidhur me shqyrtimin e parë të 'Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2030', të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (a), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për vitet 2026-2030

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të 'Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2030'.

2. Projekt-Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2030, e cekur në pikën një të këtij vendimi, cakton objektivat për zhvillim ekonomik për periudhën pesë vjeçare në territorin e komunës.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2026-2030.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.lag/Br.sv. 275
Data/Datum 09.09.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 08.09.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 02.09.2026, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 1484, të datës 21.08.2026, të paraqitur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përmes Kryetarit të Komunës, për modifikimin e projektit zbatues 'Renovimi dhe zgjerim i stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në neni 11, neni 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), neni 17, shkronja (r, s), neni 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c, l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, si dhe nenit 12, shkronja (m, n), neni 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), neni 27, shkronja (c, ç, nj) të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 1484, të datës 21.08.2026 për modifikimin e projektit zbatues 'Renovimi dhe zgjerimi i Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1484, të datës 21.08.2026, për modifikimin dhe ndryshimin e projektit zbatues nga emërtimi 'Renovimi dhe zgjerimi i Stadiumit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë, në në 'Objekt me destinim sportiv multifunksional - Stadiumi 'Ekrem Grajçevci, i cili është duke u realizuar në Ngastrën Kadastrale Nr. 776-34, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë.

2. Modifikimi i projektit bëhet me qëllim të përshtatjes me gjendjen faktike në terren, përmbushjes së kërkesave teknike të zbatimit, si dhe rritjes së funksionalitetit, cilësisë dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të objektit sportiv.

3. Realizimi i modifikimit do të bëhet në përputhje me dokumentacionin teknik të rishikuar dhe procedurat ligjore në fuqi, duke respektuar interesin publik, transparencën dhe përdorimin racional të mjeteve buxhetore për këtë projekt me rëndësi publike për zhvillimin e sportit të komunës.

4. Për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Akti u dërgohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së KRS, Drejtorisë së BF dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS * OPŠTINA KOSOVO POLJE * KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS * FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE